



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 91, Datë 11/07/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 50, datë 16.05.2019, e Znj. A.T., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Znj. A.T. është banore e qytetit të Korçës, e martuar dhe nënë e dy fëmijëve. Znj. A.T. ka arsim të mesëm dhe ka punuar në subjekte të ndryshme private. Në datën 03.08.2014, ajo është aksidentuar në punë dhe ka humbur njërin prej parakrahëve. Që prej asaj kohe, ajo është e papunë dhe prej 2 vitesh trajtohet me kemp me Vendim të KMCAK Korçë. Ankuesja rezulton e aftë për punë, por e ka tepër të vështirë të gjejë një vend pune, pasi kur aplikon pranë subjekteve private, menjëherë sapo vihet re mungesa e njëjës prej gjymtyrëve, asaj i refuzohet vendi i punës. Znj. A.T. shprehet se i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, ku është e regjistruar si punëkërkuese e papunë, që prej datës

18.10.2017 deri në datën 31.10.2018¹, por nga ana e këtij institucioni nuk është ndihmuar për të aplikuar për punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 50, datë 16.05.2019, e Znj. A.T., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, me shkresën nr. 746/1, datë 22.05.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - 1.** Informacion lidhur me periudhën kohore, përgjatë së cilës Znj. A.T. ka qenë e regjistruar si punëkërkuese e papunë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë;
 - 2.** Kopje e dosjes së ankueses, që administrohet nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë;
 - 3.** Informacion, nëse ankueses i është ofruar ndonjë mundësi punësimi, në përputhje me arsimin dhe eksperiencën e mëparëshme në punë, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë;
 - 4.** Çdo informacion tjetër, që mund të jetë i vlefshëm, për çështjen në shqyrtim.

Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe ankueses.

Në përgjigje të shkresës nr. 746/1, datë 22.05.2019, të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë ktheu përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 746/2, datë

¹ Referuar Kartelës së Punëkërkuës të papunë, nr. 424967, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë.

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

10.06.2019, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në se Znj. A.T. ka qenë e regjistruar si punëkërkuese e papunë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, prej datës 18.10.2017 – 10.01.2019. Deri në datën 10.02.2019, ankuesja ka patur statusin e punëkërkuese së papunë, në vijim nuk është paraqitur pranë këtij institucioni për 2 muaj dhe e ka humbur këtë status, duke e rifitur në 27.05.2019.

Në shkresën e sipërpërmendur theksohet fakti se rasti i Znj. A.T. është trajtuar me përparësi nga ky institucion, në kushtet kur ankuesja është me aftësi të kufizuara. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë i ka paraqitur Znj. A.T., disa oferta punësimi, si vijojnë:

- Në datën 27.03.2018 është orientuar për tek subjekti “Mare Biscuit”, në pozicionin e lirë të punës të deklaruar nga ky subjekt për individë me aftësi të kufizuara, por është refuzuar nga subjekti përkatës;
- Në datën 30.04.2018 është orientuar në subjektin “Grand Hotel”, në pozicionin e punës “sistemuese dhomash” ose punëtoresh në lavanteri, por sërisht është refuzuar nga subjekti;
- Në datën 28.06.2018 është orientuar drejt subjektit “Kotheo”, me aktivitet në konfeksione, në pozicionin “punëtoresh riparimi”, por sërisht është refuzuar.

Ankuesja është informuar nga strukturat përkatëse të këtij institucioni, që do të informohet në vazhdimësi për pozicione pune të përshtatshme për të.

Bashkëlidhur shkresës nr. 746/2, datë 10.06.2019, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, janë dërguar edhe informacioni i printuar nga databaza e sistemit elektronik.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 50, datë 16.05.2019, e Znj. A.T., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”³ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

³Ratifikuar me ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe punësimi.⁴ Në gërmën “c”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “*Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: c) në një treg gjithëpërfshirës të punësimit;*”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave.

Ankesa e Znj. A.T. drejtohet kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, ku pretendimi i saj për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, konsiston në mos ofrimin e vendeve të punës, nga ana e këtij institucioni. Znj. A.T. është individ me aftësi të kufizuara, pasi në datën 03.08.2014, ajo është aksidentuar në punë dhe ka humbur njërin prej parakrahëve. Që prej asaj kohe, ajo është e papunë dhe prej 2 vitesh trajtohet me kemp me Vendim të KMCAP Korçë. Pra, për sa më sipër, pretendimi i Znj. A.T. mbështetet më faktin e mosveprimit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, për t’i ofruar

⁴Neni 5, pika 1, e ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”parashikon: “*Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.*”

vende pune, në përputhje me aftësitë e saj profesionale⁵ dhe në përshtatje me aftësinë e saj, të kufizuar.

Nga korrespondenca zyrtare e KMD-së me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë rezulton se ankuesja është regjistruar si punëkërkuese e papunë prej datës **18.10.2017 – 10.01.2019**. Për shkak të mosparaqitjes pranë këtij institucioni, ajo e ka humbur statusin e punëkërkuetit të papunë për rreth 2-3 muaj dhe e ka rifituar atë sërish në datën 27.05.2019, kur është ri-regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë. Për sa më sipër rezulton se ky institucion i ka ofruar ankueses 3 pozicione pune, pranë subjekteve private, përkatësisht në datat 27.03.2018, 30.04.2018 dhe 28.06.2018, por ankueses i është refuzuar punësimi nga subjektet përkatëse. Njëkohësisht, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë ka shprehur predispozicionin e saj, për ta ndihmuar ankuesen në vijim, me çdo ofertë pune që do të jetë në përshtatje me kushtet e saj.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se nuk ndodhemi në kushtet e mosveprimit të institucionit të sipërpërmendur, për të ofruar pozicione pune të përshtatshme për ankuesen, por gjendemi përballë refuzimit të subjekteve private për të punësuar Znj. A.T., të cilët në kushtet kur nuk janë subjekte të ankesës nr. 50, datë 16.05.2019, nuk mund t'i nënshtrohen hetimit administrativ të KMD-së.

Në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Znj. A.T. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë. Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ka diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁵ Znj. A.T. ka përfunduar arsimin e mesëm.

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Znj. A.T., për shkakun e pretenduar në ankesë, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – te mira e shërbime
Shkak – gjendja shëndetësore